



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot.

Luc. në 26 01 2023

VENDIM

Nr. 08 Datë 23 01 2023

"Për një ndryshim në VKB nr. 106 datë 21.12.2022 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023" për dhenie të një shperblimi financiare (Honorar) " nga fondi reserve"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2013 të Ministrisë Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe akteve ligjore e nën ligjore të tyre në VKB nr. 106 datë 21.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023" për Bashkinë Kurbin, dhe në kërkesat drejtuar Kryetares së bashkisë nga Drejtoria e Arsimit Kultures Rinise dhe Sporteve, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI;

1. Dhenien e një shperblimi financiare (Honorar) për personin në fuqi dhe kontribut të veçantë për vendin, për interes kombëtarë, për shoqërinë dhe komunitetin si më poshtë:

1	Boris Sander FRROKAJ	100,000	Per rezultatet e larta ne Sportin e Mundjes
2	Elderit Alfred KACI	100,000	Per rezultatet e larta ne Bilardo
	Shuma	200,000	

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë:

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Financave

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber AFKA



KRYETARE E KESHILLIT

Edlira HESHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 308/1 prot.

Laç, më 20.01 .2023

VENDIM

Nr. 02 , datë 23 / 01 .2023

**“PËR MIRATIMIN E OBJEKTIT “RRUGE KALIML PER KALIMIN E
AUTOMJETEVE, FSHATI DROJE, FUSHE MAMURRAS, N.J.A. MAMURRAS,
KURBIN”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, ligjin 97/80 datë 06.07.2007 “Për Inspektimin e odërtimit” i ndryshuar, urdhërin e kryetares së Bashkisë Kurbin, në mbështetje të kërkesave të qytetarëve të fshatit Droje, Fushe Mamurras, Mamurras, gjithashtu në kërkesën e Agjencisë së Infrastruktura Rrugore Dhe Shërbimeve Mbeshtetese, pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë, Keshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Miratimin e aksesit rrugor per kalimin e automjeteve, ne aksin pergjate tumit Droje
2. Te pershtatet i gjithë aksi i plote per kalimin e automjeteve.
3. Te kryhen punimet e nevojshme per kthimin e ketij aksi ne gjendje optimale.
4. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kurbin të marrë të gjitha masat për inspektimin dhe mbështetjen e kryerjes së punimeve.
5. Policia Bashkiake, Agjencia e Infrastrukturës Rrugore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse të Bashkisë Kurbin të ndjekin problematikat dhe mbarëvajtjen ditore të këtij aksesi.
6. D.P.K./H.F Kurbin te ndjeko te gjithe procedurat me paisjen e lejes perkatese.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë)ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi nglarkohet Kryetaria e Bashkisë

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>D.P.K.ZH.F

>Arkivit

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 313/2 prot.

Laç, më 26.07.2023

VENDIM

Nr. 06, datë 23/01/2023

“PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I KURBINIT ”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “a”, nenit 54, shkronja “m” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të kërkesë – propozimit të Komunitetit Zhejë nr. 6817 Prot. datë 19.12.2022, “Për dhënie titulli qytetar nderi z. Eklent Alfred Kaçi” pas propozimit nga komisioni dhe Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak :

VENDOSI;

1. Dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Kurbinit **z. Eklent Alfred Kaçi** me motivacion :

“Për vlerat e tij të jashtëzakonshme duke thyer rekorde botërore në sportin e bukur dhe inteligjent të Bilardos. Shembull për rininë kurbinase”

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

- >Prefektit Të Qarkut Lezhë
- >Drejtoria e Arsimit Kultures Rinisë dhe Sporteve
- >Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA

KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1702/Prot.

Laç, më 18 . 03 .2023

VENDIM

Nr. 20 datë 24/03/2023

“PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 168, DATË 21.12.2022 “MBI NDARJEN E BURSIVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM PARAUNIVERSITAR DHE ARSIMIT BAZË PËR VITIN MËSIMOR 2022 – 2023”

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresën Nr.6478/54 Prot., datë 11.11.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënës të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023” 30 (tridhjetë) bursa, si dhe referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 2 të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin “Për disa ndryshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 “Kërkesë për mbështetje financiare” për arsye largimi jashtë shtetit të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot pas propozimit nga ZVAP drejtorja e arsimit bashkisë dhe Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI;

Të miratojë shfuqizimin e vendimit Nr. 168, datë 21.12.2022 “Mbi akordimin gjysëm burse të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë.

>ZVAP Kurbin.

>Drejtorja e arsimit

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1701 Prot.

Laç, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 21 datë 24/03/2023

**“PËR DHËNIEN E NJË GJYSËM BURSE NJË NXËNËSI TË ARSIMIT BAZË PËR
VITIN MËSIMOR 2022 – 2023”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresën Nr. 6478/54 Prot., datë 11.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023”, 30 (tridhjetë) bursa, referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 2, të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin “Për disa ndyshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 “Kërkesë për mbështetje financiare”, për arsye largimi jashtë shtetit të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot, i cili ka përfituar burse me vendimin nr.168 është menduar që fondi i kësaj burse të kalojë tek nxënësi Mikel Gjin Gjoka, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot, Pas propozimit nga ZVAP, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

Të miratojë dhënie e një gjysëm burse, nxënësit Mikel Gjin Gjoka, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot .

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

- **Prefektit të Qarkut Lezhë**
- **ZVAP Kurbin**
- **Drejtorisë së Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sporteve**
- **Arkivit**

SEKRETAR I I KËSHILLIT

Arbër LEKA

Adresa: Lajnia Nr.3, Laç

KRYETARI I KËSHILLIT

Edlira LLESHI

E-mail bashkiakurbin@gmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1703 / Prot.

Laç, më 28 . 03 .2023

VENDIM

Nr. 22 datë 24 / 03 /2023

**“MBI SHTIMIN E EMRIT TË NJË NXËNËSI TË ARSIMIT BAZË PËR PËRFITIM
GJYSËM BURSE PËR VITIN MËSIMOR 2022 – 2023”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresën Nr. 6478/54 Prot., datë 11.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023” 30 (tridhjetë) bursa, si dhe referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 3 të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin “Për disa ndryshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 “Kërkesë për mbështetje financiare”, për arsye të nje defekti teknik (kapërcim numri rendor në listë) nxënësi Alesio Afrim Berisha i shkollës 9-vjeçare “Fran Pal Piroli” Zhejë nuk është pasqyruar në listen e nxënësve që përfitojnë gjysëm burse për vitin mësimor 2022-2023. Pas propozimit nga ZVAP Kurbin, drejtorja e arsimit dhe Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI;

Të miratojë emrin e nxënësit Alesio Afrim Berisha, shkolla 9-vjeçare “Fran Pal Piroli” Zhejë për përfitim gjysëm burse për vitin mësimor 2022-2023.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë.

>ZVAP Kurbin

>Drejtorja e arsimit .

>Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARË E KESHILLIT

Edlira LLESHI